

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/kuvendi-i-kosoves-miraton-deklaraten-per-ish-kreret-e-uk-se-kundershtojme-i106437
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:56:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4aed9dd92ce6ea0165c7e6b8e583f3dc81b754a272b35725101736b785dea4b4
TEKSTI	a15eecd7f7d989f84465e4daa3a3dd66a66185d5a26f0c9b802e7d45cce63f7f4
PAMJA	bd682e4303caa724a0b607c7ded9ffaf36f0f5b0512528d2c4259155d7e5f83f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	79f978f5527a1828f26ec0369a8c646f3babce0cfe88e658acc3ddb6b7292671
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79f978f5527a1828f26ec0369a8c646f3babce0cfe88e658acc3ddb6b7292671>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: së përbashkët politike kosovare ■ ngjante. Të gjitha trupat ameri ■ shantazhi politik në reaguat Partia Demokratike. ■ Vudi Xhymshiti faqet e tij në rrjetet sociale ■ efektivëve dhe projektit që parashikon fuqitë ■

KOSOVA

Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 17:50



Kuvendi i ri i Kosovës ka miratur të hënën, në seancën e tij të parë plenare, një deklaratë lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Speciale të Kosovës në Hagë ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Deputetët thanë se e konsiderojnë "si të papranueshëm përfundimin për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal" të katërshe.

Në foltoren e Kuvendit, kryeparlamentarja Albulena Haxhiu lexoi deklaratën për të cilën ranë dakord Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca dhe Grupi Parlamentar Multietnik.

Çfarë thuhet në deklaratë?

Deklarata e 28 shtatorit u miratua me 99 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Më vonë, Kuvendi zgjodhi nënkryetaren e tij nga radhët e PDK-së, Vlorë Çitakun, dhe caktoi anëtarët e komisioneve parlamentare. Miratimi i deklaratës për Specialet u bë në kohën kur PDK-ja po propozon ndryshime në projektligjin e atyre që zyrtarisht njihen si Dhomat e Specializuara të Kosovës, pas dënimit me gjithsej 81 vjet burgim për krime lufte ndaj Thaçit, Krasniqit, Veselit dhe Selimit.

Projektligji i PDK-së, i propozuar javën e kaluar, kërkon që juridiksioni i Gjykatës Speciale të kufizohet te veprat penale të përmendura në një raport të vitit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i cili trajtonte, ndër të tjera, pretendimet për trafikim organesh pas luftës në Kosovë. Ai parasheh ndryshimin e periudhës kohore që mbulon Specialja: nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000, në periudhën nga 1 korriku i vitit 1999 deri në dhjetorin e vitit 2000.

PDK-ja propozon, gjithashtu, që ndëshkimi maksimal që do të mund ta shqiptonte Gjykata të jetë 15 vjet burgim.

Projektligji parasheh edhe që dënimet të ekzekutohen në Kosovë, dhe që personat e dënuar të mund të jenë subjekt i faljes presidenciale. Mbështetje kësaj nisme i ka dhënë Aleanca, teksa LVV në pushtet tha se do të shqyrtojë fillimisht në aspektin juridik, ndërsa LDK ende nuk ka një qëndrim zyrtar për këtë.

Më 16 shtator, Specialja dënoi me nga 25 vjet burgim Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin, me 18 vjet burgim Kadri Veselin dhe me 13 vjet burgim Rexhep Selimin. Pas shqiptimit të dënimit ndaj ish-eporëve të UÇK-së në Hagë, u organizuan protesta për çdo natë në Prishtinë në kundërshtim të aktgjyimit.

Rezolutat e mëparshme

Në shkurt 2026, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë që u kërkon Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë të garantojnë gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare dhe duke respektuar të drejtat e të akuzuarve.

Rezoluta kërkonte gjithashtu transparencë dhe llogaridhënie, ndërsa konfirmoi zotimin e Kosovës për mbështetjen financiare të mbrojtjes së të akuzuarve. Po ashtu edhe në vitin 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), përmes së cilës shprehu qëndrimin se lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe se vlerat e saj duhet të ruhen e të mbrohen. Përmes kësaj rezolute Kuvendi i Kosovës u kishte propozuar institucioneve kompetente që, në përputhje me ligjin për dhënie e dekoratave, t'i dekoronin për merita të veçanta komandantët dhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Rezolutat e miratuara në Kuvend pasqyrojnë qëndrim dhe vullnet politik për një çështje, por pa një detyrim ligjor/REL

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 28 Shtator14:56

[UÇK-ja bashkon politikën/ 99 deputetë pro deklaratës së përbashkët për ish-krerët e UÇK-së](#)

Çështja e katër ish-krerëve të UÇK-së në Hagë bashkoi partitë politike kosovare në Kuvend. 99 deput...

KOSOVA 28 Shtator14:39

[I dogjën shtëpinë e prindërve, gazetari në Kosovë Vudi Xhymshiti poston pamjet: Nuk ndalem...](#)

Gazetari nga Kosova Vudi Xhymshiti ka ragura me një postim në faqet e tij në rrjetet sociale kur parqet shtëpinë e djegur një di...

KOSOVA 28 Shtator08:50

[Pse s'flitet për viktimat e krimeve të luftës?](#)

Në stallë lopësh e bodrume, të lidhur me zinxhirë, të mbuluar me baltë dhe të rrethuar me jashtëqitje njerëz...

KOSOVA 28 Shtator08:09

[“Jo në emrin tim”/ Nga Londra nis zëri që kërkon drejtësi për çlirimtarët](#)

Në qendrën e kryeqytetit britanik, në një prej qyteteve ku vendoset dhe debatohet çdo ditë për fatet e botës, zë...

KOSOVA 27 Shtator22:54

[Dënimi i ish-krerëve të UÇK, mijëra persona mbledhen në Prishtinë](#)

Mijëra qytetarë janë mbledhur sonte në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, në mbështetje të ish-kre...

KOSOVA 27 Shtator18:27

[“200 metrat” që liruan Gotovinën dhe mësimi për katërshen e UÇK-së](#)

Gjykata konstatoi se Gotovina dhe gjenerali Mlladen Markaç kishin marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kri...

KOSOVA 27 Shtator15:58

[“Dosja 23” në Zubin Potok/ 9 të arrestuarit për krime lufte ndalohen për 48 orë, publikohen pamjet nga aksioni](#)

Prokuroria Speciale dhe Policia e Kosovës kanë publikuar të dhëna të reja dhe pamje nga aksioni i sotëm në Zubin Potok, ku u ...

KOSOVA 27 Shtator15:34

[REL: Nga dënimi te pafajësia, ja çfarë mësimi sjell rasti Gotovina për apelin e ish-krerëve të UÇK-së](#)

Pas dënimit për krime lufte të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli...

KOSOVA 27 Shtator10:01

[Kosova i kërkon dorëheqjen, ministrja e Drejtësisë: S’kam bashkëpunuar me Hagën](#)

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Donika Gërvalla, mohoi se ka bashkëpunuar me Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe tha se...

KOSOVA 26 Shtator17:26

[Edhe pulat nga Tajlanda/ 197 tonë mish përmes Kosovës, raporti i KE ngre pikëpyetje për kontrollet](#)

Shqiptarët konsumojnë mish pule nga Tajlanda. Që prej 3 shtatorit, BE-ja dhe vendi ynë kanë ndaluar importin e disa kategorive të ...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 27 Shtator

[I martuar me një grua ruse, si u kap gafil elba...](#)

Detaje të reja kanë dalë nga operacioni, për kapjen në Rusi të Salvatore alias Shpëtim Aliut në Federatën Ruse, ku ...

LIFESTYLE 28 Shtator

[Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që ...](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mirë&e...

Lulëzimi i çiftit Ergys dhe Dorina Verdho/ Nga ...

Çifti Ergys dhe Dorina Verdho duhet të merret si “shembull” nga familjet shqiptare për mënyrën sesi kanë shumëf...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.